



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit
“Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, evaduar në vitin 2023”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT *(Auditim Tematik)*

**“Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e
përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, në Agjencinë Kombëtare të
Bregdetit, evaduar në vitin 2023”**

Tiranë, mars 2025

	<i>Përmbajtja</i>	
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
I.1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të auditimit	3
I.2	Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh	4
I.3	Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh	4
I.4	Konkluzioni i përgjithshëm mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve	5
II	HYRJE	6-7
II.1	Objekti i auditimit	6
II.2	Qëllimi i auditimit	6
II.3	Metodologjia e auditimit	7
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA	8-28
	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	
III.1	Zbatimi i rekomandimeve për <i>masat me karakter organizativ</i> . Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar..	8-27
III.2	Zbatimi i rekomandimeve për <i>masa disiplinore dhe administrative</i> . Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.	28-29
IV	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	30-33

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

KLSH në zbatim të Standardit Ndërkombëtar të Auditimit, ISSAI 100, që ka përcaktuar se “SAI-et kanë rol në monitorimin e veprimeve të ndërmarra nga pala përgjegjëse në përgjigje të çështjeve të ngritura në raportin e auditimit. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, përqendrohet në faktin nëse subjekti i audituar ka adresuar në mënyrën e duhur çështjet e ngritura”;

- të nenit 15, shkronja (j) dhe pikës 2 të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”;

- të Programit të Auditimit nr.1477 prot., datë 12.12.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, ka kryer auditimin e përputhshmërisë “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, (AKB), evaduar në vitin 2023”.

Audituesit e KLSH janë fokusuar në auditimin mbi hartimin e planit të veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna, për marrjen e masave organizative, të masave disiplinore etj, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH për misionin e mëparshëm të realizuar në këtë objekt, ku rezultoi se:

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse Nr. 561/19 Prot. datë 18.12.2023 janë dërguar për zbatim përfundimet e auditimit, ku janë rekomanduar për zbatim: 22 masa organizative si dhe është kërkuar marrja e masave disiplinore për drejtuesit dhe zyrtarët e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit (AKB), sipas përgjegjësisë të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- ▶ Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, **22 masa organizative**, (rekomandime që janë shqyrtuar nga subjekti i audituar AKB dhe përfshirë në planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve), të cilat nga subjekti janë pranuar plotësisht. Niveli i zbatimi tyre paraqitet si vijon: janë zbatuar plotësisht 16 rekomandime, janë në proces zbatimi 3 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 3 rekomandime¹, ndërsa rezultoi i pa zbatuar 1 rekomandim.
- ▶ Për shkeljet e konstatuara, i janë rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së që, në vlerësim të parregullsive të konsideruara nga KLSH, sipas pikës 1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe **dhënien e masave disiplinore** për personat përgjegjës të referuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara. Rezulton se nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, është ndjekur procedura administrative për dhënien e masës disiplinore *vetëm* për Specialistin e Sektorit Juridik dhe Ankimeve Administrative, për rrjedhojë konsiderohen të zbatuara pjesërisht.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Disa nga problematikat e konstatuara nga auditimi i mëparshëm lidhen me moszbatimin e kriterëve dhe të kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi; me inspektimin e mjediseve dhe të dokumentacionit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike; me disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, me kontrollin për zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi; me marrjen e masave, vendosjen e gjobave /masave administrative për shkeljet

¹ -Referuar “Manualit të Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve si dhe Regjistrin Institucional të Zbatimit të Rekomandimeve”, miratuar me Vendimin nr.67, dt 13.6.2020 te Kryetari të KLSH: ”Audituesi, mbi bazën e shqyrtimit të dokumentacionit konkludon se brenda afatit të përcaktuar për secilin rekomandim, **subjekti** (ose struktura përkatëse brenda subjektit) **nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimin sipas llojit** (përmirësim ligjor, organizativ, shpërblim dëmi, administrativ, disiplinor etj.), si dhe **ka pushuar së vepruari në përjekjen e tij për zbatim**” (fq 15)

e konstatuara nga subjektet me shkelje në ushtrimin e veprimtarive turistike; me shqyrtimin e ankesave për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve, me ndjekjen e plotë të procedurave të ekzekutimit të detyrimeve monetare të subjekteve të gjobitura, me qëllim arkëtimin e shumave në favor të buxhetit të institucionit, etj..

1.2. Hartimi i programit (Plan i veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën “j”, të nenit 15, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, që përcakton të drejtën e KLSH që “të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara..., për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”.

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Më datë 21.12.2023 është protokolluar në AKB me nr.prot. 1779/5, raporti përfundimtar i Auditimit. Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AKB më datë 09.01.2024 me nr. prot.49/1 ka dërguar Plan Veprimin për zbatimin e rekomandimeve.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Nga auditimi rezulton se Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka hartuar dokumentin “Plan Veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”, (Nr. 49 prot. datë 09.01.2024), i cili është dërguar me shkresën përcjellëse Nr. 49/1 Prot., datë 09.01.2024.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 49/1 Prot, datë 09.01.2024, brenda afatit ligjor.

Sa më sipër rezulton, se është zbatuar afati **20 ditor** për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

1.3- Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”).

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka dërguar me shkresën përcjellëse me Nr. 49/2 Prot., datë 19.06.2024 ku ka informuar mbi “Plan Veprimi për Zbatimin e e Rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Nga ana e subjektit të audituar lidhur me raportimin mbi zbatimin të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara sipas strukturave përgjegjëse, subjekti ka raportuar në KLSH brenda afatit **6 mujor** të raportimit, sipas ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30 pika 2 e tij.

Sa më sipër rezulton, se është zbatuar afati **6 mujor** për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

I.3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

1. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr. 561/19 Prot. datë 18.12.2023, rezulton se, nga **23** masa të rekomanduara (*masa organizative dhe disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **23** masa të rekomanduara ose ~ 100%.

Nga rekomandimet e pranuar (23): janë zbatuar plotësisht **16**, ose 70 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht **3** masë ose 13 %, janë në proces zbatimi **3** masa ose 13 % dhe nuk janë zbatuar **1** masë ose ~4 %.

Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën ~70 %, gjë e cila tregon se Agjencia Kombëtare e Bregdetit e ka vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim Ligjor	-	-	-	-	-
2	Organizative	22 masa	16	2	3	1
3	Shpërblim dëmi	-	-	-	-	-
4	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	-	-	-	-	-
4	Masa Disiplinore	1 masë	-	1	0	-
	<i>Gjithsej</i>	23 masa	16 masa	3 masa	3 masa	1 masë

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel 100%, konkretisht nga **23** rekomandime gjithsej, janë pranuar **23** rekomandime.

Statusi i zbatimit të rekomandimeve: të zbatuara plotësisht rezultojnë në masën ~**70%**, niveli i zbatimit të rekomandimeve pjesërisht dhe në proces rezultoi ~**26%**, niveli i rekomandimeve pa zbatuara rezultoi **4 %**, nivele këto të cilat tregojnë vlerësimin e këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr.1477 prot., datë 12.12.2024, KLSH kreu auditimin e përputhshmërisë “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, evaduar në vitin 2023”,

Grupi i auditimit i përbërë nga:

1. Z. Q.C. -përgjegjës grupi,
2. Znj.Xh. K., -anëtar,
3. Znj.Sh. H. -anëtar.

të autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së ka vlerësuar dokumentacion dhe informacionet e dërguara nga subjekti i auditimit, lidhur me statusin e zbatimit të rekomandimeve të lëna për auditimin e përputhshmërisë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ushtruar auditimin e përputhshmërisë në “Agjencinë Kombëtare të Bregdetit”, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2022 në bazë të Programit të Auditimit nr. 561/1 prot., datë 30.06.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij auditimi janë miratuar me Vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 213, datë 17.12.2023 dhe përfundimet e auditimit janë dërguar në subjekt me shkresën nr. 561/19 , datë 18.12.2023.

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e përputhshmërisë”, rezulton se auditimi është kryer për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 213, datë 17.12.2023, si dhe përcjellë në subjekt me shkresën Nr.561/19 Prot., datë 18.12.2023, (protokolluar në AKB me nr. 1779/5 prot., datë 21.12.2023).

Dokumentacioni i auditimit për verifikimin e rekomandimeve:

Nga grupi i auditimit, bazuar në Aktin e Verifikimit të datës 17.01.2025 mbi verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve, (protokolluar në AKB me nr.197 prot, datë 17.01.2025) u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili është përcjellë zyrtarisht në subjektin e audituar sipas shkresës nr.1477/1 prot., datë 17.02.2025.

Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit, AKB sipas shkresës me nr. 528/3 prot, date 28.02.2025, (administruar në KLSH me nr. 1477/2 datë 03.03.2025), me lëndë “Kthim përgjigje dhe kërkesë për bashkëpunim në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit të KLSH-së”, ka dërguar observacionet dhe komentet përkatëse, të cilat janë trajtuar sipas çështjeve përkatëse të këtij raporti përfundimtar të auditimit.

1. Objektivat e auditimit

Mbi dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të kryer në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, si dhe dhënien e një opinioni/konkluzioni objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në përmirësimin e punës menaxhuese të njësisë publike.

2. Qëllimi i auditimit

Të vlerësojë dhe evidentojë masat e marra nga subjektet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve, hartimin e matricave (plan veprimi ose masash) për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë aktet administrative përkatëse (urdhurat) të nxjerra për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë dokumentacionin që shoqëron dhe vërteton zbatimin e rekomandimeve, si dhe të verifikojë nxjerrjen

e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore dhe pasqyrimin në dosjen personale të punonjësve. Të verifikojë dhe dokumentojë me kujdes nëse janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të gjobave të vendosura, etj.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të Agjencinë Kombëtare të Bregdetit dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punës në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi. Për këtë arsye, zbatimi i rekomandimeve ka një rëndësi të veçantë në identifikimin e masave që ka marrë institucioni përkatës për eliminimin e mangësive të konstatuara në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese dhe punonjësit e subjektit Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, për problematikën e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim, mbajnë përgjegjësi në lidhje me zbatimin e e kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, për fushën e veprimtarisë shtetërore.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, duke planifikuar e kryer auditimin me qëllim arritjen e nivelit të sigurisë së kërkuar.

6. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit.
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), “Udhëzuesit e INTOSAI-t”, etj.

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve.

8. Metodologjia e auditimit

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodën e përdorur gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

- Auditim i njëpasnjëshëm e me zgjedhje sipas cilësimeve të bëra në drejtimit e auditimit.
- Verifikimi i Urdhrave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur *Akt-verifikimi datë 17.01.2025* sipas çështjeve respektive të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmbyllës me përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

III/1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencia Kombëtare e Bregdetit kryen veprimtarinë e saj referuar ligjit nr.93/2015, datë 27.07.2015 “Për turizmin”, VKM-së, nr.569, datë 17.07.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, dhe Urdhrit nr. 217, të Kryeministrit, datë 01.11.2024 “ Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKB-së”, etj.

Referuar përcaktimeve të pikes nr.6, të VKM nr. Nr. 569, datë 17.7.2019, AKB-ja, në përputhje me kompetencat/ përgjegjësitë e veta, *kryen këto detyra:*

a) Krijon dhe përditëson Inventarin Kombëtar të Zonës Bregdetare; b) Jep kontribut në informimin, konsultimin dhe aksesin e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave e të strategjive të lidhura me menaxhimin e integruar të zonës bregdetare; c) Merr pjesë në hartimin e politikave e të strategjive kombëtare për menaxhimin e integruar të bregdetit dhe bashkërendimin e punës për zbatimin e tyre; ç) Propozon ndryshime dhe përmirëson kuadrin ligjor e nënligjor për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare; d) Bashkëpunon me organet përkatëse për projektet dhe aktivitetet për mbrojtjen e zhvillimin e bregdetit dhe monitorimin e zbatimit të tyre; dh) Nxit dhe bashkëpunon me organizma, institucione, investitorë dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë apo vendas dhe i fton ata për pjesëmarrje e përfshirje në projektet dhe zhvillimet me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare; e) Monitoron zbatimin me përpikmëri të instrumenteve të planifikimit të territorit, të miratuara nga autoritetet qendrore e vendore në zonën bregdetare; ë) Kontrollon zbatimin e kriterëve dhe të kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi; f) Ushtron kontroll dhe inspekton në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike; g) Inspekton dhe monitoron rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare dhe respektimin e rregullave për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare; gj) Inspekton dhe kontrollon zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi; h) Merr masa, vendos gjoba/masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit; i) Shqyrton ankesat për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve; j) Ndjek procesin e ekzekutimit të detyrimeve monetare të subjekteve të gjobitura, me qëllim arkëtimin e shumave në favor të institucionit; k) Lajmëron organet shtetërore kompetente në rastet kur vërehen shkelje administrative, veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin, duke u propozuar organeve përkatëse marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës, si dhe përgatit kallëzimin penal për veprat penale të vëna re gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi; l) Vlerëson nevojat dhe harton buxhetin vjetor e afatmesëm të institucionit; ll) Siguron burimet njerëzore dhe garanton zhvillimin – trajnimin e tyre në përputhje me kërkesat e pozicionit të punës, si dhe kryen vlerësimin e performancës; m) Mirëmban pajisjet dhe asetet në dispozicion për zhvillimin e veprimtarisë; n) Kryen detyra të tjera të dhëna me akte ligjore dhe nënligjore.

Fushëveprimi i këtij auditimi përfshin procedurat e ndjekura nga Agjencia Kombëtare të Bregdetit, lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve që janë lënë në auditimin e mëparshëm, për mangësitë, parregullsitë e shkeljet e konstatuara për aktivitetin e kryer për periudhën 2021-2022, trajtuar sipas drejtimeve të programit të mëparshëm të auditimit.

III/2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2/1- Realizimi i rekomandimeve të lëna, si pas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, rezulton si më poshtë:

Referuar dokumentacionit të administruar nga AKB për zbatimin e rekomandimeve (dokumentet, shkresat apo çdo veprim tjetër zyrtar i ndërmarrë nga institucioni për të zbatuar rekomandimet e lëna) konstatohet se ecuria e zbatimit të çdo rekomandimi është si vijon:

1.Gjetje: Nga auditimi u konstatua se, informacioni për parashikimin e dy viteve PBA 2021-2023 si dhe 2022-2024, nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit për shkak se nuk disponohet në formë elektronike por as në formë shkresore. Arsyeja sulmi kibernetik që u bë mbi disa platforma ndër të cilat edhe AKSHI, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”, i ndryshuar, neni nr. 43 dhe Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, neni nr. 17. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 10-14, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

1.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që të gjitha dokumentet të përpilohen dhe të mbahen edhe në formë shkresore si dhe të protokollohet dhe arkivohen për të krijuar sigurinë e mbajtjes dhe disponibilitetin e informacionit duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Në zbatim të rekomandimit 1.1 të Raportit Përfundimtar të KLSH-së, përcjellë me shkresën Nr.561/19 prot., datë 18.12.2023, Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka marrë masa për përpilimin e dokumenteve të Programit Buxhetor Afatmesëm për parashikimin e dy viteve 2024-2026, Faza I dhe Faza II, protokolluar në AKB, përkatësisht Nr. 1034 Prot., datë 03.05.2024 dhe Nr.2842 Prot., datë 29.08.2023 dhe përpilimin e dokumenteve të Programit Buxhetor Afatmesëm për parashikimin e dy viteve 2025-2027, Faza I dhe Faza II, protokolluar në AKB, përkatësisht Nr.1274 Prot., datë 29.04.2024 dhe Nr.3587 Prot., datë 04.09.2024

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi, konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

2.Gjetje: Nga auditimi u konstatua se në bazë të dokumentacionit e vënë në dispozicion, si dhe nga auditimi i kryer në librat e magazinave ka parregullsi në mbajtjen e artikujve pas hyrjes dhe daljes së tyre në magazinë. Grupi i auditimit ka konstatuar se mbajtja e artikujve në librat e magazinës bëhej pa një kronologji dhe pa një rregullshmëri të caktuar në hedhjen e tyre në këto libra. Gjithashtu, grupi i auditimit ka konstatuar se nuk është kryer një rakordim periodik ndërmjet magazinës dhe zyrës së financës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 30-37, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Sektori i Burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në AKB , të bëjë sistemimin e dokumentacionit në librat të magazinës si dhe të bëhet mbajtja e artikujve në librat e magazinës në mënyrë kronologjike dhe të rregullt.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Në zbatim të rekomandimit 2.1 të Raportit Përfundimtar të KLSH-së, përcjellë me shkresën Nr.561/19 prot., datë 18.12.2023, Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka realizuar mbajtjen e artikujve në librat e magazinës në mënyrë kronologjike dhe sistematike, si dhe ka kryer rakordimin e gjendjes fizike me atë kontabël së magazinës deri më datë 30.06.2024, në zbatim të Urdhrit të Brendshëm me Nr.134 datë 05.08.2024, Nr.3151 prot.datë 05.08.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për rakordimin mbi gjendjen fizike dhe kontabël të magazinës në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit”. Informacioni për sa më lartpërmendur është dhënë nga grupi i punës në shkresën më Nr. 3151/1 datë 09.08.2024.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

3. Gjetje: Nga auditimi i përdorimit të karburantit në institucionin e AKB-së grupi i auditimit konstatoi disa mangësi në dokumentimin e përdorimit të karburantit si:

- Përgjithësisht Fletët e Udhëtimit nuk ishin të nënshkruara nga punonjësit e AKB-së për të justifikuar lëvizjet e kryera si dhe Fletë Udhëtimit përgjithësisht, nuk janë shoqëruar me faturat tatimore të subjekteve ku është marrë karburanti pavarësisht se, në sistem sasia e karburantit rezulton e konsumuar veprime këto, në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika nr. 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 34-39, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)*

3.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që në vijimësi, të gjithë punonjësit e AKB-së që përdorin automjetet e këtij institucioni të kryejnë dokumentimin e plotë të përdorimit të karburantit dhe ky dokumentacion të shoqërohet me Faturat Fiskale për çdo konsum karburanti.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Në zbatim të rekomandimit 3.1 të Raportit Përfundimtar të KLSH-së, përcjellë me shkresën Nr.561/19 prot., datë 18.12.2023, Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka marrë masa që dokumentet për përdorimin e karburantit të jenë të plotësuar me nënshkrimet e personave përgjegjës, si dhe shoqëruar me faturat tatimore për çdo përdorim.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit, konkretisht grupi i auditimit ka verifikuar fletët e udhëtimit për periudhën mars-korrik 2024, që rezultojnë të nënshkruara rregullisht.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

4. Gjetje: Nga auditimi u konstatua se, përlllogaritja e fondit limit nga “Komisioni për përlllogaritjen e karburantit për institucionin” nuk është bërë në mënyrë të detajuar pasi nuk janë përcaktuar shumë faktor të rëndësishëm si numri total i inspektimeve, monitorimeve, verifikimeve etj, të kryera gjatë viteve të kaluara. Për sa më sipër nuk është bërë një përlllogaritje e detajuar për totalin e kilometrave të përshkruara në vitet e kaluara për të arritur në një përlllogaritje më të saktë për nevojat e institucionit të AKB-së për karburant për automjetet në dispozicion të tij, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 2875, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe Udhëzimi nr. 6, datë 16.01.2018, “Përlllogaritja e vlerës së marrëveshjes

kuadër” pika nr.7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 21-36, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)

4.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa dhe të bëhet një përllogaritje e saktë dhe e detajuar mbi nevojat e institucionit për punë, mallra dhe shërbime, në çdo procedurë me qëllim realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe përdorimin me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Në lidhje me rekomandimin e lënë, në përllogaritjen e bërë për furnizimin me karburant për vitin 2024-2025 janë marrë masat si më poshtë:

Është përcaktuar norma e konsumit të karburantit për kilometër për të gjitha automjetet në inventar të AKB-së. (urdhri i brendshëm nr.57, datë 19.02.2024 “Për ngritjen e komisionit për përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për kilometër për automjetet në inventar të AKB-së”

Është marrë parasysh historiku i sasisë së konsumuar të karburantit nga vitet e mëparshme 2022-2023, i konsumuar kryesisht gjatë inspektimeve dhe monitorimit të shërbimit të pastrimit.

Janë marrë parasysh kontratat e mëparshme të furnizimit me karburant për vitet 2022-2023. Është bërë përllogaritja e sasisë së nevojshme të karburantit për monitorimin e zonës bregdetare të pastrimit duke iu referuar distancave të zonës ku do të kryhet monitorimi dhe normës së konsumit të karburantit për kilometër të automjeteve.

Sa më sipër, përllogaritja e naftës për dy vitet e ardhshme për AKB-në është bërë në mënyrë të detajuar, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me rekomandimet e KLSH.

Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit, AKB sipas shkresës me nr. 528/3 prot, date 28.02.2025, (administruar në KLSH me nr. 1477/2 prot., datë 03.03.2025), me lëndë “*Kthim përgjigje dhe kërkesë për bashkëpunim në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit të KLSH-së*”, ka dërguar observacinet dhe komentet ku theksohet sa vijon:

“Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka ngritur dy Urdhra të Brendshëm referuar qëndrimit mbi gjetjen nr.4, konkretisht Urdhër i Brendshëm nr.63 datë 20.02.2025 “Për Ngritjen e Komisionit për Përcaktimin e Normës së Konsumit të Karburantit për Kilometër për Automjetet në Inventar të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit” për të përcaktuar normën e konsumit për automjetin me targa: AA...P si dhe Urdhër i Brendshëm nr.62 datë 20.02.2025, “Për Përcaktimin e Normës së Konsumit të Karburantit për Kilometër për Automjetet në Inventar të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit në Përdorim nga Agjencitë Rajonale të Bregdetit” për përcaktimin e normës së konsumit për automjetet me targë, AA..B; AB...Y, AA...Y dhe AA...I. (Bashkelidhur shkresës urdhat e sipër cituar).

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Në zbatim të urdhrin nr. 57, datë 19.02.2024 “Për ngritjen e komisionit për përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për km për automjetet në inventar të AKB” është përcaktuar norma e konsumit të karburantit për kilometër për disa nga automjetet në inventar të AKB-së, nga Komisioni (me përbërje M.Z., L.K. dhe E.H.), janë mbajtur procesverbalet përkatëse të përcaktimit të normës së konsumit të karburantit për kilometër për automjetet në inventar të AKB-së, me nr. 367 datë 09.02.2024, nr. 347 datë 08.02.2024, nr. 432 datë 16.02.2024 dhe nr. 342 datë 07.02.2024. Nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit nuk është përcaktuar deri në datën e kryerjes së verifikimeve në AKB, norma e konsumit për automjetet me targa: AA ...P, AA ...B; AB...Y, AA ...Y, AA...I.

Për sa më sipër, trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është në proces zbatimi, për të cilat duhet vijuar zbatimi i plotë i rekomandimit dhe përcaktimit të normës së konsumit për automjetet e përfshirë në dy urdhrat e mësipërm, nr.62 dhe 63, datë 20.02.2025 të AKB.**

5.Gjetje: Nga auditimi u konstatua se, për blerjet e vogla në procedurat e prokurimit publik në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit u konstatuan disa problematika.

a- Nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

b- Nuk është nënshkruar:

-procesverbali i marrjes në dorëzim të dokumentacionit të operatorit fitues;

-nuk është përpiluar procesverbali i dorëzimit të dokumentacionit të operatorit fitues që duhet të firmoset nga Komisioni i Prokurimit për Procedurat me Vlera të Vogla si dhe nga Operatori Ekonomik fitues;

- nuk është përpiluar procesverbali i vlerësimit dhe gjeneruar nga sistemi Raporti i Vlerësimit, nuk është gjeneruar nga sistemi dhe bashkangjitur praktikës Raporti Përfundimtar. Për sa më sipër, të gjitha këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 29-34, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)*

5.1. Rekomandim: Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të marrë masa në plotësimin me dokumentacionin e nevojshëm si dhe zbatimin e të gjitha procedurave të prokurimit publik për të garantuar besueshmëri në zhvillimin e procedurës së prokurimit si dhe vlerësim dhe shpalljen e operatorit fitues.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nga viti 2022, janë të pajisura të gjitha me dokumentacionin e duhur. Nga KPVV për çdo procedurë janë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit, janë hartuar procesverbalet e marrjes në dorëzim të dokumentacionit nga operatorët ekonomikë, janë hartuar procesverbalet e vlerësimit dhe janë gjeneruar nga sistemi të gjitha raportet e domosdoshme për çdo procedure prokurimi.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit, konkretisht grupi i auditimit ka verifikuar 2 procedura prokurimi me: urdhër prokurimi nr. 98, datë 20.05.2024; urdhër prokurimi nr. 88, datë 03.05.2024. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

6.Gjetje: Nga auditimi u konstatua se, për blerjet e vogla nën 100,000 lekë pa TVSH.

- Për vitin 2021, janë zhvilluar nga 9 procedura, ku në 6 raste, nuk është bërë hedhja në sistemin e APP-së, duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- Për vitin 2022, janë zhvilluar 6 procedura ku , në 4 raste nuk është bërë hedhja në sistemin e APP-së.

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 31-37, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të marrë masa që në fazën e hartimit të regjistrit të parashikimeve të procedurave të

prokurimit të përfshijë këto blerje në procedurat normale të prokurimit me vlerë të vogël për të minimizuar mundësinë e abuzimit me fondet e institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Për vitin 2023-2024, regjistri i parashikimeve është hartuar i detajuar, sipas formatit të parashikuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe ndarja e zërave është bërë duke iu referuar rekomandimeve të KLSH. Gjithashtu, për çdo procedurë nën 100.000 lekë, nga KPVV janë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Regjistri i parashikimeve dërguar me shkresën me nr. 90 prot., datë 11.01.2024 në Degën e Thesarit, janë parashikuar 6 procedura deri në vlerën 100.000 lekë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2021, Drejtoria për Sigurimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit dhe Zonave Bregdetare, nuk ka hartuar programin vjetor të inspektimit, por kanë kryer inspektimet në mënyrë rastësore, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 24, Kreu IV në Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pikën 2.2 dhe 2.7, Kreu II të Urdhrit nr.13, datë 23.04.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në RSH”, pikën 4 dhe 5 të Kreut I të Urdhrit nr.5, datë 19.02.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 59-61, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

7.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Drejtoria për Sigurimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit dhe Zonave Bregdetare, të marrin masat e nevojshme, që për çdo vit, ta hartojnë dhe miratojnë programet vjetore dhe mujore të inspektimit për fushat përkatëse të aktivitetit të tyre, duke respektuar kërkesat ligjore në përmbajtjen e informacionit të tyre dhe afatet e përgatitjes dhe miratimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit për Sigurimin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, ka hartuar në zbatim të afateve dhe ka dërguar në Inspektoratin Qendror për mendim këshillimor, programet vjetore dhe mujore të inspektimeve. Rekomandimi është zbatuar dhe zbatohet në vazhdimësi. Bashkëlidhur dokumentacioni vërtetues mbi programet vjetore .

-Program vjetor 2024, nr. 3091 prot, datë 06.10.2023.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, për 25 subjekte nga të cilat 13 me veprimtari ”Operator Turistik” dhe 12 subjekte me veprimtari” struktura

Akomoduese” në listat e verifikimeve, në rubrikën “Komente” evidentohet se subjektet e planifikuara për inspektim kanë qenë të mbyllura fizikisht, nga inspektorët nuk janë verifikuar në sistem nëse subjektet kanë status aktiv. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 60-69 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

8.1.Rekomandim:Agjencia Kombëtare e Bregdetit, nëpërmjet Drejtorisë për Sigurimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit dhe Zonave, të marrë masa për hartimin e një regjistri me subjektet e konstatuara të mbyllura nga inspektimet dhe të konfirmojë statusin e gjendjes së regjistrimit, aktiv apo pasiv si biznes në QKB-së, me qëllim që të hartojnë dhe nxjerrjen e autorizimeve për kryerjen e inspektimeve, ndaj subjekteve që janë aktiv, në të kundërt të merren masa administrative (gjobë) sipas ligjit në fuqi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit për Sigurimin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, ka plotësuar regjistrin me subjektet e konstatuara të mbyllura nga inspektimet.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Regjistri i subjekteve të konstatuara të mbyllura nga inspektimet(dërguar me email grupit të auditimit) përmban në total 29 struktura akomoduese, nga të cilat 26 subjekte i përkasin vitit 2024 dhe 24 agjenci turistike,që i përkasin vitit 2023.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, dokumentacioni në sistemin e-inspektime, në përgjithësi, i mungonte dokumentacioni bashkëlidhur, veprime në kundërshtim me Urdhrin nr. 25, datë 10.08.2018 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” si dhe pikën 2.2 dhe 2.7, Kreu II të Urdhrit nr. 13, datë 23.04.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në RSH”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 60-71, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

9.1.Rekomandim: Inspektorët e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, të marrin për çdo subjekt të inspektuar të hidhen të gjithë dokumentacionin në sistem e-inspektime, që ndodhet në subjekt, në të kundërt të merren masa administrative me gjobë sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit për Sigurimin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, në zbatim të rekomandimeve të lëna, ka plotësuar dokumentacionin për çdo subjekt në sistemin e-inspektime. Bashkëlidhur dokumentacion vërtetues nga inspektorët.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit, konkretisht grupi i auditimit ka shqyrtuar 3 subjekte inspektimi dhe rezultoi se dokumentacioni është në përputhje me legjislacionin në fuqi: subjekti A.M., N. Dh., M. Ll.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, për vitin 2021-2022 janë marrë 44 masa administrative (gjoba) për subjektet që ushtrojnë aktivitetin pa kontrata “stacione plazhi”. Por nga AKB, nuk ka korrespondencë zyrtare / shkresa informuese drejtuar Policisë Bashkiake, apo dhe një bashkëpunim me inspektorët e taksave pranë NJQV-ve, për marrjen e masave për pezullimin e aktivitetit të paligjshëm dhe lirin e hapësirave publike.Por, janë mjaftuar vetëm me masën administrative gjobë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 52-78, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

10.1.Rekomandim:Agjencia Kombëtare e Bregdetit, të mundësojë korrespondencë zyrtare / shkresa informuese , në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore, të marrë masë në rastet e konstatimit të ushtrimit të aktivitetit pa kontratë, të sekuestrojnë dhe të bëjnë të mundur lirin e hapësirave publike të zaptuara pa drejtësisht /kontratë.

Nr	Subjekti	Veprimtaria	Bashkia	Nipt	Adresa	Dt inspektimit	Grupi insp.	Dt. Pv
1	S. J.	Stacion Plazhi	Himarë	L...N	Himarë	27.07.2021	E. B., A. M., K.J.	27.07.2021
2	Gj. K.	Stacion Plazhi	Himarë	L...Q	Rr.Qendër	28.07.2021	H. T., F. S., M. B.	28.07.2021
3	V. B.	Stacion Plazhi	Himarë	L...V	Lgi.Potam Gd.nr.2	29.07.2021	L. V., E. H., F. H.	29.07.2021
4	A. K.	Stacion Plazhi	Pogradec	L...U	Fshati Lin	03.08.2021	A. M., F. S.	03.08.2021
5	A.I.	Stacion Plazhi	Lezhë	L...R	Lezhë	05.08.2021	M. B., E. H.	05.08.2021
6	A.N.	Stacion Plazhi	Vlorë	L...Q	Orikum-Plazh,	09.08.2021	M.B., E. H.	09.08.2021
7	L.F.	Stacion Plazhi	Vlorë	L...K	Lagjia Orikum-	09.08.2021	M. B., E. H.	09.08.2021
8	S.	Stacion Plazhi	Golem	J.Ë	Golem	17.08.2021	H. T., F. V.	17.08.2021
9	Z. M.	Stacion Plazhi	Kavajë	L...O	Karpen	19.08.2021	M. B., A. M.	19.08.2021
10	B.H.	Stacion Plazhi	Durrës	L...R	Durrës	24.08.2021	L. V., K. J.	24.08.2021
11	L. S. g.	Stacion Plazhi	Durrës	M...S	Lagjia Iliria, nr 13, Durrës	24.08.2021	A. M., E. H.	24.08.2021
12	Rr. S.	Stacion Plazhi	Ksamil	L...J	Ksamil	27.08.2021	L. V., K. J.	27.08.2021
13	Q.V.	Stacion Plazhi	Ksamil	L...B	Ksamil	27.08.2021	L. V., K. J.	27.08.2021
14	D. P.	Stacion Plazhi	Tale Lezhë	L...N	Tale Lezhë	16.06.2022	L.V., K.J.	16.06.2022
15	S. T.	Stacion Plazhi	Shkëmbi i Kavajes	L...H	Shkëmbi Kavajës	22.06.2022	L. V., K. J.	22.06.2022
16	D. K.	Stacion Plazhi	Zvernec	L...A	Zvernec	27.06.2022	H. T. F. S.	27.06.2022
17	A. P.	Stacion plazhi		L...F	Lezhë	14.06.2022	S. M. M. B.	14.06.2022
18	T.2.	stacion plazhi		L...I	Lezhë	14.06.2022	S.M., M. B.	14.06.2022
19	E.P.	stacion plazhi		L...N	Lezhë	16.06.2022	L. V., K. J.	16.06.2022
20	Z.D.	stacion plazhi		L...H	Durrës	22.06.2022	L.V. K. J.	22.06.2022
21	I. Sh.	stacion plazhi		L...A	Vlorë	27.06.2022	F.S. H.T.	27.06.2022
22	M. H.	stacion plazhi		M...P	Vlorë	27.06.2022	L.V. K. J.	27.06.2022

23	M.C.	stacion plazhi	G. S.	L...N	Vlorë	28.06.2022	F.S., H. T.	28.06.2022
24	L. C.	stacion plazhi	K. M.	L...V	Himarë	29.06.2022	Z.D., E. H.	29.06.2022
25	K. P.	stacion plazhi	Z. K.	H...E	Lezhë	05.07.2022	H. T., F. V.	05.07.2022
26	E. C.	stacion plazhi	D.N.	L...L	Lezhë	05.07.2022	L. V. K. J.	05.07.2022
27	Z.K.	stacion plazhi	N.R.	H...J	Lezhë	05.07.2022	H.T., F. V.	05.07.2022
28	D. N.	stacion plazhi	A.K.	M...O	Lezhë	05.07.2022	M.B. A. M.	05.07.2022
29	N. R.	stacion plazhi	B. P.	L...V	Lezhë	05.07.2022	L. V. K. J.	05.07.2022
30	A.K.	stacion plazhi	L.R.	L...R	Lezhë	05.07.2022	Z. D., E. H.	05.07.2022
31	B.P.	stacion plazhi	J. H.	H...H	Shkodër	06.07.2022	F.S., H. T.	06.07.2022
32	P. K.	stacion plazhi	D. C.	G...V	Sarandë	08.07.2022	Z.D., E.H.	08.07.2022
33	I.K.	stacion plazhi	Sh.Xh.	M.H	Sarandë	08.07.2022	L. V. K. J.	08.07.2022
34	G. H.	stacion plazhi	F. K.	L...K	Kavajë	12.07.2022	L. V. K. J.	12.07.2022
35	E.A.	stacion plazhi	V.T.	M...R	Fier	14.07.2022	L.V. K. J.	14.07.2022
36	A. B.	stacion plazhi	Sh.P.	L...F	Durrës	25.07.2022	Z. D. E.H.	25.07.2022
37	F.A.	stacion plazhi	I.M.	L...E	Durrës	25.07.2022	Z. D. E. H.	25.07.2022
38	I. M.	stacion plazhi	A. K.	L...N	Durrës	25.07.2022	L. V. K. J.	25.07.2022
39	N. T.	stacion plazhi	E. H.	L...V	Pogradec	28.07.2022	H.T. F.S.	28.07.2022
40	V. B.	stacion plazhi	K. S.	M...R	Pogradec	29.07.2022	H.T., F.S.	29.07.2022
41	J. 2..	stacion plazhi	S. H.	M...V	Vlorë	02.08.2022	H.T. F.S.	02.08.2022
42	N. C.	stacion plazhi	I. B.	L...J	Himarë	09.08.2022	H.T. F.S.	09.08.2022
43	P.	stacion plazhi	Th. R.	L...B	Himarë	09.08.2022	H. T. F.S.	09.08.2022
44	D. L.	stacion plazhi	V. C.	L...K	Sarandë	15.08.2022	M.B. F. V.	15.08.2022

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Përsa i përket 44 subjekteve të gjobitura për shkak të mungesës së kontratës së plazhit nuk ka korrespondencë zyrtare / shkresa informuese drejtuar Policisë Bashkiake për marrjen e masave të mëtejshme dhe nuk është konstatuar gjatë viteve 2023-2024 ushtrimi i veprimtarisë së këtyre subjekteve pa kontratën e stacionit të plazhit.

Në zbatim të rekomandimeve të lëna, gjatë sezonit turistik 2024, AKB i është drejtuar Policive Bashkiake të rajoneve përkatëse për marrjen e masave për lirimin e hapësirave publike të zaptuara nga subjekte që ushtronin aktivitetin stacion plazhi pa u pajisur me kontratë, të cilat dhe janë gjobitur me masë administrative gjobë, në zbatim të gërmës j, pika 1, neni 71, Ligji nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar.

Bashkëlidhur dokumentacioni vërtetues:

Shkresa nr.3215 prot, datë 07.08.2024.
Shkresa nr.3545 prot, datë 30.08.2024.
Shkresa nr.3497 prot, datë 28.08.2024.
Shkresa nr.3498 prot, datë 28.08.2024.
Shkresa nr.3499 prot, datë 28.08.2024.
Shkresa nr.3500 prot, datë 28.08.2024.
Shkresa nr.3501 prot, datë 28.08.2024.
Shkresa nr.2096/5 prot, datë 06.08.2024.
Shkresa nr.3043/1 prot, datë 06.08.2024.

Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit, AKB sipas shkresës me nr. 528/3 prot, date 28.02.2025, (administruar në KLSH me nr. 1477/2 prot., datë 03.03.2025), me lëndë “*Kthim përgjigje dhe kërkesë për bashkëpunim në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit të KLSH-së*”, ka dërguar observacionet dhe komentet ku theksohet sa vijon:

“Drejtorja e Inspektimit dhe Kontrollit për Sigurimin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, në zbatim të rekomandimeve të lëna, gjatë sezonit turistik 2024, i është drejtuar Policive Bashkiake të rajoneve përkatëse për marrjen e masave për lirim dhe hapësirave publike të zaptuara nga subjekte që ushtronin aktivitetin stacion plazhi pa u pajisur me kontratë, të cilat dhe janë gjobitur me masë administrative gjobë, në zbatim të germës j, pika 1, neni 71, Ligji nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar. Rekomandimi është zbatuar gjatë vitit 2024 dhe do të zbatohet në vazhdimësi.

Krahas dokumentacionit të dërguar sqarojmë se përse i përket sekuestrimit, Ligji i Posaçëm dhe VKM për stacionet e plazhit nuk e parashikon kryerjen e sekuestrimit nga AKB. Ligji i Inspektimit përcakton procedurën për të gjitha llojet e inspektorateve, ku sipas fushës aplikohen masa të ndryshme përkatëse. Gjithashtu, sekuestrimi i plazheve duke qenë në juridiksionin e NJQV, bëhet prej tyre me adresim nga ana e AKB-së, siç përcaktohet dhe në nenin 11, VKM nr. 171.”

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit, konkretisht për subjektet e konstatuara pa kontratë, Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka dërguar shkresë përcjellëse në polici bashkiake/njësi vendore, ka marrë masa administrative, por nuk rezulton të ketë raste sekuestrimi.

Nga ana tjetër, lidhur me pretendimet e AKB sipas shkresës me nr. 528/3 prot., date 28.02.2025, sqarojmë se misioni i këtij angazhimi auditimi është verifikimi i rekomandimeve të lëna sipas shkresës së KLSH me Nr. 561/19 Prot. datë 18.12.2023.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është i zbatuar pjesërisht.**

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për vitin 2021- 2022, që janë vendosur gjithsej 105 gjoba, në vlerë totale 13,080 mije lekë, nga këto kanë likuiduar 11 subjekte kryesisht me vlerë likuiduese 1,660 mije lekë, me likuidimi vullnetare, janë pa arkëtuar në vlerën 87,440 mijë lekë, duke mos ndjekur procedurat ligjore sipas “Kreut VI ,neni 45,46, te ligjit nr. 10433,datë 16.06.2011 si dhe Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 9, shkronja b pika 4 të nenit 30, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 52-78, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit.*)

11.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, sektori juridik të marrin masat e nevojshme për ndjekjen e 94 gjobave në vlerën në vlerën 87,440 mijë lekë dhe të ndjekin të gjitha procedurat ligjore në procese gjyqësore/dhe deri në arkëtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Referuar Rekomandimit nr. 11, gjatë periudhës 2021-2022, janë vendosur gjithsej 105 gjoba administrative, të cilat pasqyrojnë masat e marra ndaj subjekteve për shkeljet përkatëse. Nga ky total, 13 gjoba janë vendosur në vitin 2021, ndërsa 92 janë regjistruar në vitin 2022.

Për sa më sipër Sektori Juridik dhe i Ankimeve Administrative në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit ju bëjmë me dije se, (bashkëlidhur dhe tabelën)

Për gjobat e vitit 2021:

Duke u ndjekur në përmbarim = 7 gjoba total në vlerën 1,400,000 lekë

Nr.	Nr. i aktit administrativ	Subjekti	Vlera e gjobes	Administrator	Nr. Vendimit per venie ne ekzekutim	Nr. kërkesës "Për vënien në ekzekutim të vendimit drejtuar Përmbaruesit
1	Nr. AKB-DQ-2021-000004-5 27.07.2021	S. J.	200,000	S. J.	1756 datë 11.04.2023	1110/1 datë 08.05.2023
2	Nr. AKB-DQ-2021-000014-5 03.08.2021	A. K.	200,000	A. K.	3506 datë 23.07.2024	3312 datë 14.08.2024
3	Nr. AKB-DQ-2021-000024-5 05.08.2021	A. I.	200,000	A. I.	1400 datë 16.06.2023	457/2 datë 06.07.2023
4	Nr. AKB-DQ-2021-000043-5 24.08.2021	B. H.	200,000	B.H.	3880 datë 13.02.2024	792 datë 20.03.2024
5	Nr. AKB-DQ-2021-000044-5 24.08.2021	L. S. G.	200,000	F. Q.	3886 DATË 10.10.2023	4162 datë 24.10.2023
6	Nr. AKB-DQ-2021-000052-5 27.08.2021	Rr.S.	200,000	Rr.S.	1420 datë 04.04.2023	1248/1 datë 18.05.2023
7	Nr. AKB-DQ-2021-000053-5 27.08.2021	Q. V.	200,000	Q.V. I. B.	1417 datë 05.4.2023	1113/1 datë 08.05.2023
			1,400,000			

Për gjobat e vitit 2022:

- Duke u ndjekur në gjykatë = 10 gjoba në vlerën 950,000 lekë
- Duke u ndjekur në përmbarim = 23 gjoba në vlerën 3,830,000 lekë

Total = 33 gjoba në vlerën 4,780,000 lekë

Nr.	Nr. i aktit administrativ	Subjekti	Vlera e gjobes	Nr. Urdhrit Gjykata Për Lëshimin e Ekzekutimit
1	Nr. AKB-DQ-2022-000128-5 20.06.2022	V. D.	200,000	653 datë 21.03.2023
2	Nr. AKB-DQ-2022-000273-5 23.08.2022	A. M.	50,000	2785 datë 10.07.2024
3	Nr. AKB-DQ-2022-000228-5 13.07.2022	E. C.	200,000	3751 datë 04.10.2024
4	Nr. AKB-DQ-2022-000357-5 01.11.2022	"H. A."	100,000	4128 datë 29.10.2023
5	Nr. AKB-DQ-2022-000520-5 07.11.2022	"Sh. 0" sh.p.k.	50,000	944 datë 02.04.2024
6	Nr. AKB-DQ-2022-000456-5 21.11.2022	A. D.	50,000	3823 datë 15.10.2024
7	Nr. AKB-DQ-2022-000324-5 14.10.2022	E.A.	100,000	Kërkesë Padi Subjekti ndaj AKB-së nr. 797 datë 20.03.2024
8	Nr. AKB-DQ-2022-000329-5 14.10.2022	R. H.	100,000	4151 datë 23.10.2023
9	Nr. AKB-DQ-2022-000325-5 14.10.2022	H. R.	50,000	3010 datë 24.07.2024
10	Nr. AKB-DQ-2022-000358-5 01.11.2022	H. "V."	50,000	Në pritje të afatit të ankimit për t'u nisur kërkesa Gjykatës

totali		950,000		
Nr.	Nr. i aktit administrativ	Subjekti	Vlera e gjobes	Nr. Urdhrit Gjykata Për Lëshimin e Ekzekutimit
1	Nr. AKB-DQ-2022-000005-5 12.05.2022	V. P.	200,000	1753 date 11.04.2023
2	Nr. AKB-DQ-2022-000006-5 13.05.2022	E.L.	200,000	1764 date 20.03.2023
3	Nr. AKB-DQ-2022-000021-5 18.05.2022	M. V.	200,000	1758 date 28.04.2023
4	Nr. AKB-DQ-2022-000040-5 26.05.2022	D.Ç.	200,000	1768 date 06.06.2023
5	Nr. AKB-DQ-2022-000063-5 06.06.2022	A.C.	200,000	1757 date 05.04.2023
6	Nr. AKB-DQ-2022-000066-5 27.05.2022	D. K.	200,000	1755 date 20.03.2023
7	Nr. AKB-DQ-2022-000123-5 17.06.2022	Sh.T.	200,000	1829 date 27.04.2023
8	Nr. AKB-DQ-2022-000125-5 16.06.2022	V.B.	200,000	2376 date 19.05.2023
9	Nr. AKB-DQ-2022-000127-5 20.06.2022	E.B.	200,000	1831 date 07.04.2023
10	Nr. AKB-DQ-2022-000189-5 01.07.2022	D.P.	200,000	1940 date 14.04.2023
11	Nr. AKB-DQ-2022-000193-5 07.07.2022	S. K.	200,000	1410/2 prot, dt 29.05.2023 ne permbarim
12	Nr. AKB-DQ-2022-000207-5 12.07.2022	E.R.	200,000	1938 date 28.04.2023
13	Nr. AKB-DQ-2022-000231-5 14.07.2022	N. R.	200,000	1935 date 06.09.2023
14	Nr. AKB-DQ-2022-000232-5 14.07.2022	A. K.	200,000	Në Permbarim
15	Nr. AKB-DQ-2022-000234-5 14.07.2022	L.R.	200,000	2449 date 01.06.2023
16	Nr. AKB-DQ-2022-000296-5 23.08.2022	E. C.	20,000	1956 date 07.04.2023
17	Nr. 1633 Prot 03.08.2022	Sh.P.	200,000	2171 date 17.05.2023
18	Nr. 1631 Prot 03.08.2022	B.B.	200,000	1942 date 09.06.2023
19	Nr. 1739 Prot 10.08.2022	L.C.	200,000	1955 date 09.06.2023
20	Nr. AKB-DQ-2022-000422-5 14.11.2022	Sh. M.	50,000	4754 date 03.06.2024
21	Nr. AKB-DQ-2022-000418-5 11.11.2022	B.K.	10,000	Nr.3510 (300001-05979-80-2024), datë 04.09.2024
22	Nr. AKB-DQ-2022-000335-5 17.10.2022	Sh.Gj.	50,000	6078 date 03.06.2024
23	Nr. AKB-DQ-2022-000356-5 31.10.2022	A. Sh. "A." Sh.P.K me nipt. K...M	100,000	4729 date 03.06.2024
Totali			3,830,000	

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezultojnë se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Inspeksionit, e nënshkruar nga Drejtor Finance znj.E.C., specialiste juriste znj. Xh. B., Drejtor Inspektimi znj. E. M., përgjegjëse e sektorit të inspeksionit znj.S. M. rezultoi se detyrimet nga mospagesat e gjobave mbeten 6.180.000 lekë, për 40 subjekte.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është në proces zbatimi, për të cilat duhet vijuar ndjekja e tyre deri në arkëtimin e plotë të vlerës së gjobave të vendosura për shkeljet ligjore të konstatuara.

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, komisioni i ankimeve në 57 raste nga të cilat; në 24 raste ka tejkalar afatet ligjore 30 ditore për shqyrtimin e ankimeve, në 2 raste ka lejuar ankesën e subjektit jashtë afatit 31 ditore dhe në 28 raste nuk ka përgatitur vendimin për kthim në titull ekzekutiv nga gjykata Administrative e Shkalles së Parë Tiranë, veprime në kundërshtim me nenin 46 "Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar" të ligjit 10433, datë 16.06.2011 "Për inspeksionin në Republikën e Shqipërisë", me pikën 1, neni 132 "për afatin kohor për ankimin administrativ" të ligjit 45/2015 "Kodi Procedurës Administrative", me pikën 1 neni 132 "për afatin kohor për ankimin administrativ" të ligjit 45/2015 "Kodi i Procedurës Administrative". (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 78-80, të Projekt Raportit të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Komisioni i Ankimit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit të marri masa të paraqesë në Gjykatën Administrative për kthim në titull ekzekutiv të 28 ankesave jashtë afateve ligjore.

Nr.	Emër subjekti	NIPT	Veprimtaria	Data e Vendimit Përfundimtar
1	E.A.	K..I	Hotel	14.10.2022
2	R. H.	K...J	Hotel/Motel	14.10.2022
3	H. R.	J...L	Hotel	14.10.2022
4	Sh. Gj.	L...Q	Hotel	17.10.2022
5	H.A.	L...B	Hotel	17.10.2022

6	Hotel "D."	L...L	Hotel	18.10.2022
7	Hotel "B.."	L...C	Hotel	24.10.2022
8	S. T.	K...R	Hotel	27.10.2022
9	M.Hotel R.	L...T	Hotel	28.10.2022
10	Z. Z. Hotel	L...G	Fjetinë	31.10.2022
11	"Hotel A."	L...E/M...R	Hotel	01.11.2022
12	A.	K...M	Motel	31.10.2022
13	Hotel "V..."	L...I	Hotel	01.11.2022
14	S. H.	L...J	HOTEL	08.11.2022
15	"Sh. O." sh.p.k.	K...Ë	HOTEL	07.11.2022
16	S. B.	L...P	HOTEL	07.11.2022
17	A . sh.p.k.	J...P	HOTEL	04.11.2022
18	K. I.	L...N	HOTEL	11.11.2022
19	Sh. M.	K...D	HOTEL	14.11.2022
20	B. K. P.	L...B	HOTEL	11.11.2022
21	L. N.	K...D	HOTEL	18.11.2022
22	E. A.	L...K	HOTEL	21.11.2022
23	A.D. P.	K...P	HOTEL	21.11.2022
24	P.T.- P.	K...N	MOTEL	09.12.2022
25	Hotel "F.."	L...P	HOTEL	12.12.2022
26	S. G. -P.	L...T	fjetje dhe mëngjes	27.12.2022
27	A.K. -f.	L...M	HOTEL	02.12.2022
28	Y. S.	L...A	AGJENCI UDHËTIMI	21.06.2022

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Referuar Rekomandimit nr. 12.1, mbi 28 gjodat e vendosura përgjatë vitit 2022 ju bëjmë me dije se, Sektori Juridik dhe i Ankimeve Administrative në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit ka paraqitur për secilin subjekt pranë Gjykatë Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, “Kërkesë për Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit”, për secilin nga 28 subjektet. (bashkëlidhur dhe tabelën për secilin subjekt).

Nr.	Nr. i aktit administrativ	Subjekti	Nr. Urdhrit Gjykata Për Lëshimin e Ekzekutimit
1	Nr. AKB-DQ-2022-000324-5 14.10.2022	E. A.	Kërkesë Padi në Gjykatë Subjekti
2	Nr. AKB-DQ-2022-000329-5 14.10.2022	R.H.	Drejtuar Gjykate per Leshim Urdhri Ekzekutimi
3	Nr. AKB-DQ-2022-000325-5 14.10.2022	Hotel R.	Drejtuar Gjykate per Leshim Urdhri Ekzekutimi
4	Nr. AKB-DQ-2022-000335-5 17.10.2022	Sh. Gj.	6078 date 03.06.2024
5	Nr. AKB-DQ-2022-000334-5 17.10.2022	Hotel A.	4725(31134-8211-80-2023), datë 06.11.2023
6	Nr. AKB-DQ-2022-000337-5 18.10.2022	Hotel "D."	4739 date 17.11.2023
7	Nr. AKB-DQ-2022-000345-5 24.10.2022	Hotel "B."	3182 date 11.07.2024
8	Nr. AKB-DQ-2022-000349-5 27.10.2022	S.T.	5168 date 03.06.2024
9	Nr. AKB-DQ-2022-000352-5 28.10.2022	M. H. R.	Kërkesë Padi në Gjykatë Subjekti
10	Nr. AKB-DQ-2022-000354-5 31.10.2022	Z.Z. H.	4757 date 03.11.2023
11	Nr. AKB-DQ-2022-000357-5 01.11.2022	"Hotel A."	Drejtuar Gjykate per Leshim Urdhri Ekzekutimi
12	Nr. AKB-DQ-2022-000356-5 31.10.2022	A.	4729 date 03.06.2024
13	Nr. AKB-DQ-2022-000358-5 01.11.2022	Hotel "V."	Drejtuar Gjykate per Leshim Urdhri Ekzekutimi
14	Nr. AKB-DQ-2022-000365-5 08.11.2022	S. H.	4760 date 10.11.2023
15	Nr. AKB-DQ-2022-000520-5 07.11.2022	"Sh. O." sh.p.k.	Drejtuar Gjykate per Leshim Urdhri Ekzekutimi
16	Nr. AKB-DQ-2022-000380-5 07.11.2022	Sh. B.	4737 DATE 25.10.2023
17	Nr. AKB-DQ-2022-000382-5 04.11.2022	Hotel A. (A. Sh.P.K)	Është paguar vullneratisht.
18	Nr. AKB-DQ-2022-000398-5 11.11.2022	K. I.	4758 date 01.11.2023
19	Nr. AKB-DQ-2022-000422-5 14.11.2022	Sh. M.	4754 date 03.06.2024
20	Nr. AKB-DQ-2022-000418-5 11.11.2022	B. K.	Nr.3510 (300001-05979-80-2024), datë 04.09.2024
21	Nr. AKB-DQ-2022-000432-5 18.11.2022	L. N.	4763 date 03.06.2024
22	Nr. AKB-DQ-2022-000445-5 21.11.2022	E.A.	4738 date 10.11.2023
23	Nr. AKB-DQ-2022-000456-5 21.11.2022	A. D.	Drejtuar Gjykate per Leshim Urdhri Ekzekutimi
24	Nr. AKB-DQ-2022-000599-5 09.12.2022	P. T.	4722 date 03.11.2023
25	Nr. AKB-DQ-2022-000618-5 12.12.2022	Hotel "F."	Nr.3508 (300001-05977-80-2024), datë 04.09.2024
26	Nr. AKB-DQ-2022-000549-5 27.12.2022	S.G.	Nr.3181 (300001-05123-80-2024), datë 04.09.2024
27	Nr. AKB-DQ-2022-000561-5 02.12.2022	A. K.	4762 date 12.02.2024
28	Nr. AKB-DQ-2022-000103-5 30.05.2022	Y. Sh.	4756 date 24.01.2024

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar plotësisht**.

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Komisioni i Ankimimit, në 8 raste ka shfuqizuar vendimet administrative, ku në prani nuk ka patur autoritetin përkatës, i cili ka marrë vendimin, pra ka gjykuar në mungesë të inspektorëve të cilët kanë vendosur gjrobat për kundërvajtjet e konstatuara, çka bie ndesh me VKB nr. 59 datë 17.07.2019 “Për Organizimin de Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit” si dhe ligjin nr. 91/2015 Për Turizmin “si dhe të ligjit 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin ne Republikën e Shqipërisë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 75-78, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Komisioni i Ankimimit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit të marri masa dhe të mos shqyrtojë ankesat dhe të mos marrë vendime pa praninë e inspektorëve që kanë marrë vendimet administrative.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Në lidhje me rekomandimin e formuluar për Komisionin e Ankimeve në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, ku kërkohet që të merren masa për të garantuar praninë e inspektorëve që kanë marrë vendimet administrative gjatë shqyrtimit të ankesave, situata përcaktohet nga ndryshimet e fundit në ligjin për inspektimin.

Duke qenë se ligji “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” është në proces ndryshimi ky rekomandim nuk është vënë në zbatim ende.

- Konkretisht sipas Projekt ligjit me qëllim krijimin e një procesi transparent dhe të besueshëm për shqyrtimin e ankimit administrativ ndaj masave administrative të marra nga trupat inspektuese, duke e bërë pjesë të Inspektoratit të Përgjithshëm, duke shmangur konfliktin e interesit.

Neni 13, Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit të Përgjithshëm, pika i) trajton të gjitha informacionet, ankesat, denoncimet e ardhura nga qytetarë ose persona fizikë apo juridikë mbi veprimtarinë e inspektorëve si dhe procedurat e inspektimit të drejtuara sipas formave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, përfshirë edhe ankesat që kryhen në platformën ndërqeveritare të ndërveprimit.

Aktualisht jemi në pritje të miratimit përfundimtar të ligjit me qëllim zbatimin e rekomandimeve në përputhje me ligjin e ri.

Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit, AKB sipas shkresës me nr. 528/3 prot, date 28.02.2025, (administruar në KLSH me nr. 1477/2 prot., datë 03.03.2025), me lëndë “*Kthim përgjigje dhe kërkesë për bashkëpunim në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit të KLSH-së*”, ka dërguar observacionet dhe komentet ku theksohet sa vijon:

“Komisioni i Ankimeve në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, krijohet dhe funksionin sipas përcaktimeve të pikës 6/1, të VKM-së nr. 569, datë 17.7.2019, ”Për Miratimin e Kompetencave, mënyrën e Organizimit dhe të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”. Sa më sipër, AKB ka vijuar shqyrtimin e ankimeve me komisionin e përbërë sipas parashikimeve nënligjore, pa prezencën e inspektorëve.

Në këto kushte AKB, për efekt lehtësimit të procedurave të punës, kërkon bashkëpunimin dhe ndihmën e KLSH-së, mbi argumentin e bazës ligjore, ku përcaktohet (referimi ligjor), që inspektorët duhet të jenë pjesë e komisioneve të tilla, me qëllim, që të propozojë këtë kërkesë tek inspektorët dhe në funksion të proceseve gjyqësore, në rastet kur masat ankimohen në gjyq”.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Rezulton se edhe përgjatë vitit 2024, janë kryer në total

12 komisione ankimimi në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të cilët janë zhvilluar pa praninë e inspektorëve.

Në lidhje me pretendimet e AKB ku kërkohet përcaktimi i bazës ligjore nga ana e KLSH-së, sqarojmë se, referuar Kushtetutës dhe nenit 4 të Ligjit nr 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, “Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë shtetëror i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë, i pavarur, i cili i ushtron kompetencat e tij duke iu nënshtruar Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi.”

Si i tillë, institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk është organ këshillimor për institucionet publike.

Nga ana tjetër, sqarojmë se misioni i këtij angazhimi auditimi është verifikimi i rekomandimeve të lëna sipas shkresës së KLSH-së, me Nr. 561/19 Prot. datë 18.12.2023.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në 13 raste nga auditimi me zgjedhje i praktikave të inspektimit ndaj agjencive dhe operatorëve turistik, janë hartuar autorizime vetëm për një pikë të Ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin”, konkretisht pajisja me licencë, (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 59-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1. Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa dhe të hartojë autorizimet ku të përfshihen të gjitha kushtet e licencave sipas subjekteve përkatëse.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Nga Drejtoria e Inspektimit është marrë parasysh si rekomandim dhe është vijuar të operohet me të gjitha kriteret sipas ligjit.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar plotësisht**.

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në procedurën e prokurimit të kontratës së shërbimit me objekt: “Pastrimi i zonës bregdetare për Bashkitë Durrës, Sarandë, Kavajë dhe Himarë”. Përzgjedhja e ekspertit të jashtëm për kryerjen e justifikimit të fondit limit nuk i është nënshtruar procedurave të konkurrimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.20211 “Për blerjet me vlera të vogla dhe zhvillimi nëpërmes sistemit elektronik” por përzgjedhja e tij është bërë drejtpërdrejtë me një kontratë të përkohshme pune. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 19-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1. Rekomandim: Titullari i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, të marrë masa dhe të nxjerrë përgjegjësitë për komisionin e blerjeve të vogla, që nuk ka vepruar sipas udhëzimeve në fuqi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Në vitin 2024, për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për shërbimin me objekt” Shërbim i pastrimit të zonës bregdetare të bashkisë Shkodër, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Vlorë, Himarë dhe Sarandë” është përzgjedhur nëpërmjet procedurave të prokurimit publik. Duke qenë se nga studimi i tregut rezultoi se ky shërbim nuk e kalonte vlerën 100.000 lekë pa tvsh, është zhvilluar jo nëpërmjet sistemit SPE, por janë respektuar të gjitha hapat procedural për zhvillimin e blerjes së këtij shërbimi dhe sipas rekomandimeve të KLSH për zhvillimin e kësaj procedure.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, lidhur me dorëzimin e produktit për tenderin e pastrimit të zonës bregdetare, Eksperti i kontraktuar ka depozituar shkresën nr. 358/2 datë 11.04.2022 “Dërgim dokumentacioni tekniko-ekonomik për kryerjen e shërbimit të Pastrimit të Zonës Bregdetare për 4 Bashkitë Durrës, Kavajë, Himarë, Sarandë”.

-Komisioni i marrjes në dorëzim të produktit ka nënshkruar procesverbalin e marrjes në dorëzim pa oponencë apo kërkesë për sqarim ndaj raportit të dorëzuar me nr. prot.358/2, datë 11.4.2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 21-26 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

16.1 Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, të marrë masa dhe në raste të ngjashme komisionet të studiojnë materialet dhe të paraqesin për aprovim nëpërmjet një informacioni pranë titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Në lidhje me këtë rekomandim, marrja në dorëzim e materialit të hartuar nga specialisti i fushës për shërbimin e pastrimit për vitin 2024, nuk i është nënshkruar një verifikimi apo oponence, pasi AKB jo vetëm e ka të pamundur për shkak të mungesës së specialistit të fushës, por sipas dhe komunikimit me APP-në, në të tilla raste, materiali i dorëzuar nga eksperti i fushës, i kontraktuar, nuk i nënshkohet kontrollit, pasi eksperti mban përgjegjësi mbi materialin e dorëzuar dhe jo grupi i marrjes në dorëzim. Kjo gjë vërtetohet dhe me nënshkrimin e deklaratës për përgjegjësinë profesionale të nënshkruar nga vetë eksperti i kontraktuar. Kjo praktike ndiqet nga shumë institucione të tjera që kontraktojnë ekspert të jashtëm për nevoja institucionale (KPP, ASHPP, MB, etj). Oponenca nuk ushtrohet për procedurat e prokurimit por për procedurat koncensionare ose PPP. Në vitin 2024, grupi i marrjes në dorëzim të materialit të hartuar nga eksperti i fushës për shërbimin e pastrimit të zonës bregdetare, ka marrë në dorëzim materialin fizikisht, në numër faqe dhe dokumentacion bashkelidhur, por jo duke verifikuar konstatimet e ekspertit, aprovimin e tij apo oponence. Grupi i marrjes në dorëzim, nuk mund të kryejë një detyrë të tillë pasi jo vetëm AKB nuk ka ekspertë të fushës por nuk e ka një kompetencë të tillë. Përgjegjësia mbi atë material të hartuar i takon vetëm ekspertit të kontraktuar.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Nga ana e audituesve të KLSH-së është kërkuar vënie në dispozicion e komunikimit zyrtar me APP, por nuk rezulton të ketë një praktikë shkresore të komunikimit. Me shkresën nr .4044 prot., datë 13.11.2024, Agjencia Kombëtare e Bregdetit i është drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me objekt “marrjen e masave për hartimin e relacionit për argumentimin e fondit limit, specifikimeve teknike për procedurën “Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për vitin 2025 për bashkitë Shkodër, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë”.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është në proces zbatimi, për të cilin duhet vijuar ndjekja në vijimësi e rekomandimit**.

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Kombëtare e Bregdetit nuk ka përfunduar Inventarin Kombëtar të Zonës Bregdetare, i cili konsiston në plotësimin e dosjeve fizike (foto të subjektit, dokumente plotësues nëse ka), dosjes digjitale (Dosje me informacione të mbledhura të hedhur në hartë me pozicionin përkatës) dhe fletës së inventarizimit ç'ka do të bëjë të mundur krijimin e një harte digjitale ku do të pasqyrohen subjektet që operojnë në fushën e turizmit, por kjo detyrë nuk është realizuar nga AKB. Pasuritë e identifikuar dhe ato në proces identifikimi, paraqesin të dhënat për strukturat akomoduese dhe të shërbimit, ndërkaq AKB nuk ka filluar punën për identifikimin dhe evidentimin e situatës së zonave bregdetare të hedhura në sistemin e regjistrimit fillestar”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 40-43 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

17.1 Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa dhe të ngre grupe pune për plotësimin e hartave sipas numrit të pasurive, strukturat akomoduese dhe të shërbimit dhe të bashkëpunojë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të rakordojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, mbi situatën e zonave bregdetare të hedhura në sistemin e regjistrimit fillestar, si dhe t'i kërkojë bashkive bregdetare statusin e regjistrimit të pasurive publike, përfshirë ato të transferuara, me qëllim krijimin e një inventari të zonës së bregdetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Ka qenë në proces deri në plan veprimin e fundit të dërguar pranë jush. Me ligjin e ri për “Turizmin” janë ripërcaktuar funksionet dhe kompetencat e AKB, ku inventari i zonës bregdetare nuk është më pjesë e kompetencave të institucionit, konkretisht përcaktohet si më poshtë vijon “Ligj nr. 93/2015 “Për turizmin” (ndryshuar me Ligjin nr. 114/2017, datë 18.12.2017; nr. 101/2018, datë 13.12.2018; nr. 30/2024, datë 4.4.2024), Neni 17, Funksionet dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit (ndryshuar me Ligjin nr. 30/2024, datë 4.4.2024) Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka këto funksione dhe kompetenca: a) organizimin e punës për menaxhimin e integruar të zonës bregujore; b) sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit nëpërmjet monitorimit, inspektimit dhe kontrollit të veprimtarive turistike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; c) bashkëpunimin me institucionet shtetërore, qendrore e vendore, me investitorë dhe aktorë të tjerë vendas apo ndërkombëtarë për shkëmbimin e të dhënave dhe krijimin e të gjitha lehtësive për përmbushjen e qëllimeve e të funksioneve të veprimtarisë së saj; ç) nxitjen e investimeve në zonën bregujore; d) bashkërendimin e programeve dhe projekteve zhvilluese me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregujore; dh) sigurimin e shërbimit të pastrimit të zonës bregujore gjatë sezonit turistik, në mbështetje dhe plotësim të shërbimit të ofruar nga organet kompetente të qeverisjes vendore.

Procedura e prokurimit publik për sigurimin e shërbimit të pastrimit të zonës bregujore bëhet nga AKB-ja, duke zbatuar legjislacionin në fuqi për prokurimin publik; e) kryerjen e inspektimeve për të gjitha veprimtaritë turistike në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi për inspektimin dhe marrjen e masave administrative për shkeljet e konstatuara; ë) ushtrimin e çdo përgjegjësie tjetër të përcaktuar me ligj apo në aktin nënligjor.

Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit, AKB sipas shkresës me nr. 528/3 prot., date 28.02.2025, (administruar në KLSH me nr. 1477/2 datë 03.03.2025), me lëndë “Kthim përgjigje dhe kërkesë për bashkëpunim në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit të KLSH-së”, ka dërguar observacionet dhe komentet ku theksohet sa vijon:

Agjencia Kombëtare e Bregdetit sqaron se në lidhje me inventarizimin e zonës bregdetare, me ligjin e ri për turizmin, janë ripërcaktuar kompetencat e institucionit, pjesë e të cilave nuk është me krijimi dhe përditesimi i zonës bregdetare, ligji i përket 2024-ës, ndërsa Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 569, datë 17.07 2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë

*Kombëtare të Bregdetit”, të ndryshuar, është i vitit 2019, ndaj institucioni vlerëson se: me ndryshimet VKM-së **do të pasqyrohet** dhe riformulimi i kompetencave. Ligji i ri për turizmin përcakton funksionet dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit (ndryshuar me Ligjin nr. 30/2024, datë 4.4.2024).*

1.AKB e ka nisur procesin e inventarizimit në vitin 2020, për të cilin informacioni është përmbledhur, si më poshtë.

2.Sezoni turistik veror 2020 dhe 2021, solli disa ndryshime në procesin e administrimit të plazheve lidhur me procedurat për aplikimin dhe miratimin e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit, bazuar në Vendimin e Këshillit të Nr. 171 datë 27.03.2019 "Për miratimin e Rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit ", i ndryshuar, duke sjellë reduktimin e informalitetit, duke mundësuar aplikimin online për marrjen me qira të hapësirës së plazhit.

3.Ndërsa harta e plazheve tashmë është e detajuar, sipas secilës bashki (nëse ju nevojitet mund ta vendosim ne dispozicion) e detajuar për të gjithë zonën bregdetare.

Në kuadër të këtij procesi Drejtoria e Performancës dhe Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare në AKB, ka realizuar takime me Agjencitë Rajonale të Bregdetit, për të dhënë udhëzimet e nevojshme për kryerjen e procesit të punës, në lidhje me plotësimin e dosjeve fizike, dixhitale dhe fletës së inventarizimit, ka mbikëqyrur gjithashtu edhe procesin e inventarizimit në terren, si dhe ka përfunduar hedhjen e dosjeve fizike të inventarizimit në format dixhital për të përfutur një hartë përmbledhëse me subjektet turistike në zonën bregdetare.

Inventarizimi është kryer në zonat bregdetare si më poshtë:

Bashkia Shkodër: Zona e Velipojës dhe Baks-Rrjoll;

Bashkia Lezhë: Zona e Shëngjinit, Vainit dhe Tales;

Bashkia Kurbin: Zona e Patokut;

Bashkia Durrës: Zona e Shkëmbit të Kavajës, Plazhi i Madh, Currila, Kallm, Sektori Rinia, Gjiri i Lalzit, Hamallaj;

Bashkia Kavajë: Zona e Qerretit, Plazhi Karpen, Plazhi i Gjeneralit, Mali i Robit, Zona e Golemit;

Bashkia Rrogozhinë: Zona e Spillesë;

Bashkia Vlorë: Zona e Orikumit, Zona e Radhimës, Uji i Ftohtë, Lungomare, Plazhi i Vjetër, Nartë dhe Zvërnec;

Bashkia Fier: Zona Seman dhe Darëzezë;

Bashkia Sarandë: Zona e Ksamilit, Sarandë dhe Berdeneshit;

Bashkia Himarë: Bunec, Lukovë, Porto Palermo, Qeparo, Borsh, Potam, Himarë, Llaman, Livadh, Jalë, Dhërmi, Perivol, Palasë.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka bashkëngjitur regjistrin e inventarizimit, i plotësuar deri në datën që është dërguar plani i veprimtimit.

Përditësimi i Inventarit Kombëtar të Zonave Bregdetare përcaktohet në VKM-së nr.569, datë 17.07.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit” , kapitulli III, pika 6/a. Sipas Ligjit 93/2015 “Për Turizmin” i ndryshuar, neni 17, pika ë, përcakton se Agjencia Kombëtare e Bregdetit kryen edhe këto funksione dhe kompetenca: *ushtrimin e çdo përgjegjësie tjetër të përcaktuar me ligj apo në aktin nënligjor.*

Ndryshimet në ligjin mbi turizmin janë të muajit prill 2024.

Për sa më sipër trajtuar, për sa kohë nuk janë kryer ndryshimet e VKM-së, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **i zbatuar pjesërisht**.

18.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, kontratat për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturë shërbimi janë konstatuar mangësi në elementët dhe dokumentacionin e nevojshëm, në dosje si vijon:

Në 9 raste, aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë për stacione plazhi janë miratuar me plan operimi që nuk është sipas formatit të publikuar online dhe nuk janë plotësuar nga subjekti sipas rubrikave të kërkuara;

Në 16 raste, nuk janë paraqitur fotografi të strukturës së shërbimit/ strukturës akomoduese në raport me stacionin e plazhit;

Në 5 raste, aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë për stacione plazhi janë miratuar pa certifikatat e kualifikimit të vrojtuesve;

Në 2 raste, subjekti rezulton debitor në tatime;

Në 2 raste, subjekti nuk ka të regjistruar aktivitetin “ strukturë shërbimi/strukturë akomoduese “ në ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 46-50, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

18.1 Rekomandim: Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve të marrë masa që të shqyrtojë aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit, në respektim të kriterëve dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi, duke përfshirë kontrollin e rregullshmërisë nga pikëpamja ligjore e dokumentacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Lidhur me gjetjet dhe rekomandimin tuaj, ju bëjme me dije se Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve ka zbatuar rekomandimet tuaja lidhur me respektimin e kriterëve dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi, duke përfshirë kontrollin e rregullshmërisë nga pikëpamja ligjore e dokumentacionit.

Në përgjigje të gjetjes tuaj se plani i operimit nuk është sipas formatit të kërkuar ju sqarojmë se subjekti në planin e operimit të ngarkuar në sistemin e-albania ka të pasqyruar të gjithë informacionin e pikave kryesore të cilat përmban formati standart si emrin e subjektit, NIPT, nr. e hartës së stacionit të plazhit, kodin e sipërfaqjes, sipërfaqen e përgjithshme, sipërfaqen e kërkuar, numrin e çadrave dhe numrin e shezlloneve.

Në përgjigje të gjetjes tuaj se mungojnë foto të stacionit të plazhit në raport me strukturën akomoduese ju sqarojmë se subjekti ka të ngarkuar në sistemin e-albania foto të strukturës së shërbimit/strukturës akomoduese dhe stacionit të plazhit për të cilin aplikon, si dhe foto të strukturës së shërbimit/strukturës akomoduese në raport me stacionin e plazhit. Kontratat e lidhura për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit janë lidhur pas paraqitjes nga subjekti të marrëveshjes së noterizuar me një Vrojtues Plazhi, dhe certifikatën e kualifikimit të vrojtuesit nga qendra e formimit perkatës.

Për subjektet që kanë rezultuar debitorë në tatime GTSHA ka paraqitur vërtetimin e subjektit që pasqyrojnë se është në proces gjyqësor me tatimet.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit, konkretisht grupi i auditimit ka shqyrtuar praktikën: B. S.-Durrës, A. M.-Lukovë, Gj. N. -Velipojë, M. C.-Vlorë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar plotësisht**.

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në 9 raste kontratat për ushtrimin e stacioneve të plazhit në kontratat e punës ndërmjet subjekteve dhe vrojtuesve të plazhit, është përcaktuar se vrojtuesit kanë 1-2 ditë pushim në javë. Në këto raste mungon një vetëdeklarim i subjektit, se nuk do ta ushtrojë veprimtarinë përgjatë gjithë ditëve të javës”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 49-51, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

19.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa në vijimësi, që para nënshkrimit të kontratës, subjekti duhet të paraqesë marrëveshjen e noterizuar me vrojtuesit e plazhit, e vlefshme përgjatë gjithë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Lidhur me gjetjet dhe rekomandimin tuaj, ju bëjme me dije se Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve ka zbatuar rekomandimet tuaja që kontratat e lidhura për sezonet verore, të sigurojnë që cdo subjekt të ketë shërbimin e vrojtuesit të plazhit gjatë gjithë sezonit veror (nga momenti i nënshkrimit të kontratës përgjatë gjithë kohëzgjatjes së sezonit veror).

Bashkëngjitur gjeni një shembull kontrate bashkë me dokumentacionin përkatës.

Në zbatim të dispozitave ligjore, është detyrë e subjektit dhe vrojtuesit të vendosë sinjalistikën përkatëse në mungesë të tij, si dhe e inspektoratit përgjegjës për turizmin, marrja e masave nëse konstatohet në shkelje të kriterëve të përcaktuara në VKM.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit, konkretisht grupi i auditimit ka shqyrtuar praktikën për subjektin B. S..

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

20.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në 7 raste kontratat për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturës së shërbimit , kontratat e formatit tip të qirasë nuk janë firmosur nga përfaqësues të Bashkisë së Vlorës ". *(Më hollësisht trajtuar në pikën p 4, faqet 46-54 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

20.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që të njoftojë në rrugë shkresore njësitë vendore përkatëse për nënshkrimin e kontratave, që të vijohet më tej me përcaktimin e koordinatave në terren të stacioneve të plazhit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Ju bëjmë me dije se Bashkia Vlorë, ka firmosur kontratat e depozituara pranë saj nga AKB.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme zbatimin e rekomandimit, konkretisht grupi i auditimit ka shqyrtuar kontratën me subjektin M. C..

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar plotësisht**.

21.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në 7 raste kontratat për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturës së shërbimit janë konstatuar që janë në distancë prej stacioneve të plazhit. Ndërkohë për të njëjtën situatë objektive, nga ana e Grupit Teknik të Shqyrtimit të Aplikimeve janë refuzuar 4 subjekte. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 46-54, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

21.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që ti shqyrtojë aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të

ngushtë me personat fizikë/juridikë, duke i trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjithë subjektet aplikues.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Lidhur me gjetjet dhe rekomandimin tuaj, ju bëjme me dije se Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve ka zbatuar rekomandimet tuaja lidhur me shqyrtimin e aplikimeve për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë/juridikë, duke i trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjithë subjektet aplikuar.

GTSHA, pas shqyrtimit të cdo aplikimi dhe fotove të ngarkuara nga subjekti në sistem, ka identifikuar në Google Earth strukturën (shërbim/akomoduese) që subjekti disponon.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit, konkretisht grupi i auditimit ka shqyrtuar dy ankesa të subjekteve S. K., J. N..

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **zbatuar plotësisht**.

22.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, kontratat për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturës së shërbimit është konstatuar se, anëtarët e Grupit Teknik të Shqyrtimit të Aplikimeve nuk kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në momentin e mbylljes së aplikimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 43-55 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

22.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masat që anëtarët e komisionit të shqyrtimit të aplikimeve të përpilojnë deklaratat e konfliktit të interesit në momentin e fillimit të procesit të shqyrtimit të aplikimeve për ushtrimin e veprimtarive të stacionit të plazhit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

GTSHA dhe anëtarët e saj, në përfundim të aplikimeve për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi dhe me pas njohjes me aplikimet, kanë nënshkruar deklaratën mbi konfliktin e interesave. Deklaratat i gjeni bashkëngjitur këtij raporti.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **zbatuar plotësisht**.

C .MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, pika 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit në vlerësim të parregullsisve të konsideruara nga ana jonë, sipas pikës 1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe

dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës të atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara sipas nenit 58, shkronja “b”, “c” dhe “ç” të ligjit. nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”.

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

Në lidhje me këtë rekomandim, në muajin qershor 2024, është ngritur Komisioni Disiplinor me Urdhrin nr. 109, datë 06.06.2024, për nëpunësen E. D. (*ish Specialiste në Sektorin Juridik dhe personi përgjegjës për prokurimet publike*), për procedimin e saj në lidhje me shkeljen e pretenduar në lidhje me procedurën e përzgjedhjes së ekspertit/ specialist fushe për argumentimin e shërbimit të pastrimit të zonave bregdetare. Si fillim, komisioni i ngritur doli me vendim të ndërmjetëm për nxjerrjen jashtë kompetencës lëndore të shkeljeve të pretenduara ndaj znj. E. D., ish specialiste në Sektorin Juridik dhe Ankimeve Administrative pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, pasi nuk është më nëpunës civil pranë AKB-së. Në këto kushte, përpara dërgimit të procesit Ministrisë së Drejtësisë, nga komisioni disiplinor iu la detyrë eprorit direkt të ish nëpunëses për vlerësimin e shkeljes së pretenduar. Eprori direkt, me vendim për fillimin/mosfillimin e ecurisë disiplinore, vendosi mosfillimin e ecurisë disiplinore për nëpunësin civil znj. E. D., nëpunës që ka mbajtur pozicionin e Specialistes së Sektorit Juridik dhe Ankimeve Administrative, për shkeljet e pretenduara pasi procedura e ndjekur nga specialistja për kontraktimin e ekspertit të fushës për procedurën e shërbimit të pastrimit, është e vlefshme dhe e bazuar në akte ligjore në fuqi dhe është procedurë e përdorur në praktikë nga shumë institucione të tilla si KPP, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë etj.

Sa më sipër, referuar dhe shpjegimeve të dhëna nga personi përgjegjës znj. E. D. rezulton se përzgjedhja e ekspertit është e bazuar në një nga mënyrat e ligjshme të kontraktimit sipas VKM nr. 720, datë 29.11.1995 të Këshillit të Ministrave “Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera shtetërore”, të ndryshuar e cila është në fuqi. Përzgjedhja e kësaj mënyre kontraktimi është vlerësuar si mënyra më e saktë dhe më e sigurt duke qenë se Bashkia e Tiranës kryen shërbimin e pastrimit për qytetin e Tiranës dhe është një nga të paktët institucione që ka eksperiencën dhe ekspertët në fushën e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve.

Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit, AKB sipas shkresës me nr. 528/3 prot, date 28.02.2025, (administruar në KLSH me nr. 1477/2 datë 03.03.2025), me lëndë “*Kthim përgjigje dhe kërkesë për bashkëpunim në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit të KLSH-së*”, ka dërguar observacionet dhe komentet ku theksohet sa vijon:

Referuar Projekt Raportit të Auditimit me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e përputhshmërisë dhe rregullsisë, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, evaduar në vitin 2023”, në përfundim të raportit, tek seksioni “B” Masa disiplinore, rikërkohet nga Drejtori i Përgjithshëm i AKB vlerësimi i parregullsisë të konsideruara dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës të atakuar në raportin Përfundimtar të Auditimit dërguar me shkresë nr.561/19 prot., datë 18.12.2023 në proporcion me shkeljet e konstatuara.

Referuar Raportit Përfundimtar të Auditimit, të dërguar me shkresën 561/19 datë 18.12.2023, rezulton se në seksionin IV “Gjetje dhe Rekomandime” të vetmit persona të atakuar dhe për të cilët është lënë rekomandim nga audituesit që të merren masa është Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, i cili nuk i është nënshtruar procedurave të konkurrimit për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm për përlllogaritjen e kostos ligjore të shërbimit të pastrimit dhe specifikimeve për këtë procedure.

Në lidhje me këtë rekomandim, AKB ka marrë masa për ngritjen e komisionit disiplinor për znj. E. D., e cila në momentin e përzgjedhjes së ekspertit të fushës, ka qenë jo vetëm anëtare e KPVV por edhe personi përgjegjës për prokurimet publike.

Për sa më sipër, në kushtet kur vetë rregullat e prokurimit publik ngarkojnë me përgjegjësi personin përgjegjës për prokurimet për përzgjedhjen e llojit të procedurës, është vlerësuar se dhe në rastin e përzgjedhjes së procedurës së kontraktimit të ekspertit të jashtëm, përgjegjësi duhet të mbante

personi përgjegjës për prokurimet dhe jo një komision i veçantë, i cili ngarkohet për kryerjen e një procedure me vlera të vogla.

Në rastin konkret, nuk ka patur asnjë kërkesë për KPVV për kryerjen e një procedure për kontraktimin e një eksperti të jashtëm dhe KPVV nuk e ka zbatuar, por ka patur një memo nga Njësia e Prokurimit, e cila ka hequr dorë nga argumentimi i fondit limit të procedurës së shërbimit të pastrimit për shkak të mungesës së njohurive për kryerjen e këtij procesi dhe kanë bërë kërkesë për kontraktimin e një eksperti të jashtëm. Në këto kushte, mënyra e duhur e kontraktimit të këtij eksperti i takon personit përgjegjës për ta bërë dhe jo KPVV, për këtë arsye, nga ana e titullarit është vlerësuar si e pabazuar mbajtja e përgjegjësisë e dy anëtarëve të tjerë të komisionit të prokurimit me vlera të vogla, për sa kohë ky komision nuk ka kundërshtuar apo neglizhuar një kërkesë për zhvillimin e një procedure prokurimi.

Në këto kushte, Titullari i AKB-së, duke u bazuar dhe në parashikimet nënligjore të rregullave të prokurimit publik, vlerëson se për dy anëtarët e tjerë të KPVV nuk do të ngrihet komision disiplinor, pasi ata nuk mund të mbajnë përgjegjësi për një veprim/mosveprim të cilën nuk e kanë kompetencë për ta bërë dhe që i takon personit përgjegjës ta kryejë sipas këtyre parashikimeve nënligjore.

Qëndrimi i audituesve të KLSH:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se është ngritur Komisioni Disiplinor vetëm për një punonjës, ndërsa për punonjësit e tjerë nuk ka qëndrim të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, ndërsa rekomandimi është për Komisionin e Prokurimit me Vlerë të Vogël.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **zbatuar pjesërisht**.

* * *

IV. REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën nr.561/19 prot., datë 18.12.2023, rikërkojmë të vazhdojnë procedurat ligjore, për zbatimin e plotë nga ana e këtij institucioni, të rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe atyre që janë në proces zbatimi, nëpërmjet krijimit të mekanizmave efektive për monitorimin dhe ndjekjen sistematike të rekomandimeve, si dhe pas një analize të thelluar për shkaqet e mos zbatimit të rekomandimeve.

Nga KLSH ri-kërkohet zbatimi i rekomandimeve të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimi i rekomandimeve në proces zbatimi, detajuar si më poshtë vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, për 44 subjekte të rezultuara me parregullsi nga kryerja e inspektimeve, të realizojë marrjen e plotë të masave në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore, për të mundësuar menaxhimin me efektivitet të vijës bregdetare si dhe të bëjnë të mundur lirimin e hapësirave publike të zaptuara padrejtësisht / nga subjekte pa kontratë, referuar listës së subjekteve të evidentuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm, sipas shkresën përcjellëse të KLSH me Nr. 561/19 Prot. datë 18.12.2023, për subjektet si vijon:

Nr	Subjekti	Veprimtaria	Bashkia	Nipt	Adresa	Dt inspektimit	Grupi insp.	Dt. Pv
1	S. J.	Stacion Plazhi	Himarë	L...N	Himarë	27.07.2021	E. B., A. M., K.J.	27.07.2021
2	Gj. K.	Stacion Plazhi	Himarë	L...Q	Rr.Qendër	28.07.2021	H. T., F. S., M. B.	28.07.2021
3	V. B.	Stacion Plazhi	Himarë	L...V	Lgj.Potam Gd.nr.2	29.07.2021	L. V., E. H., F. H.	29.07.2021
4	A. K.	Stacion Plazhi	Pogradec	L...U	Fshati Lin	03.08.2021	A. M., F. S.	03.08.2021
5	A.I.	Stacion Plazhi	Lezhë	L...R	Lezhë	05.08.2021	M. B., E. H.	05.08.2021
6	A.N.	Stacion Plazhi	Vlorë	L...Q	Orikum-Plazh,	09.08.2021	M.B., E. H.	09.08.2021
7	L.F.	Stacion Plazhi	Vlorë	L...K	Lagjja Orikum-	09.08.2021	M. B., E. H.	09.08.2021
8	S.	Stacion Plazhi	Golem	J.Ë	Golem	17.08.2021	H. T., F. V.	17.08.2021
9	Z. M.	Stacion Plazhi	Kavajë	L...O	Karpen	19.08.2021	M. B., A. M.	19.08.2021
10	B.H.	Stacion Plazhi	Durrës	L...R	Durrës	24.08.2021	L. V., K. J.	24.08.2021
11	L. S. g.	Stacion Plazhi	Durrës	M...S	Lagjja Iliria, nr 13, Durrës	24.08.2021	A. M., E. H.	24.08.2021
12	Rr. S.	Stacion Plazhi	Ksamil	L...J	Ksamil	27.08.2021	L. V., K. J.	27.08.2021
13	Q.V.	Stacion Plazhi	Ksamil	L...B	Ksamil	27.08.2021	L. V., K. J.	27.08.2021
14	D. P.	Stacion Plazhi	Tale Lezhë	L...N	Tale Lezhë	16.06.2022	L.V., K.J.	16.06.2022
15	S. T.	Stacion Plazhi	Shkëmbi i Kavajes	L...H	Shkëmbi Kavajës	22.06.2022	L. V., K. J.	22.06.2022
16	D. K.	Stacion Plazhi	Zverec	L...A	Zverec	27.06.2022	H. T. F. S.	27.06.2022
17	A. P.	Stacion plazhi		L...F	Lezhë	14.06.2022	S. M. M. B.	14.06.2022
18	T.2.	stacion plazhi		L...I	Lezhë	14.06.2022	S.M., M. B.	14.06.2022
19	E.P.	stacion plazhi		L...N	Lezhë	16.06.2022	L. V., K. J.	16.06.2022
20	Z.D.	stacion plazhi		L...H	Durrës	22.06.2022	L.V. K. J.	22.06.2022
21	I. Sh.	stacion plazhi		L...A	Vlorë	27.06.2022	F.S. H.T.	27.06.2022
22	M. H.	stacion plazhi		M...P	Vlorë	27.06.2022	L.V. K. J.	27.06.2022
23	M.C.	stacion plazhi		L...N	Vlorë	28.06.2022	F.S., H. T.	28.06.2022
24	L. C.	stacion plazhi		L...V	Himarë	29.06.2022	Z.D., E. H.	29.06.2022
25	K. P.	stacion plazhi		H...E	Lezhë	05.07.2022	H. T., F. V.	05.07.2022
26	E. C.	stacion plazhi		L...L	Lezhë	05.07.2022	L. V. K. J.	05.07.2022
27	Z.K.	stacion plazhi		H...J	Lezhë	05.07.2022	H.T., F. V.	05.07.2022
28	D. N.	stacion plazhi		M...O	Lezhë	05.07.2022	M.B. A. M.	05.07.2022
29	N. R.	stacion plazhi		L...V	Lezhë	05.07.2022	L. V. K. J.	05.07.2022

30	A.K.	stacion plazhi	L.R.	L...R	Lezhë	05.07.2022	Z. D., E. H.	05.07.2022
31	B.P.	stacion plazhi	J. H.	H...H	Shkodër	06.07.2022	F.S., H. T.	06.07.2022
32	P. K.	stacion plazhi	D. C.	G...V	Sarandë	08.07.2022	Z.D., E.H.	08.07.2022
33	I.K.	stacion plazhi	Sh.Xh.	M.H	Sarandë	08.07.2022	L. V. K. J.	08.07.2022
34	G. H.	stacion plazhi	F. K.	L...K	Kavajë	12.07.2022	L. V. K. J.	12.07.2022
35	E.A.	stacion plazhi	V.T.	M...R	Fier	14.07.2022	L.V. K. J.	14.07.2022
36	A. B.	stacion plazhi	Sh.P.	L...F	Durrës	25.07.2022	Z. D. E.H.	25.07.2022
37	F.A.	stacion plazhi	I.M.	L...E	Durrës	25.07.2022	Z. D. E. H.	25.07.2022
38	I. M.	stacion plazhi	A. K.	L...N	Durrës	25.07.2022	L. V. K. J.	25.07.2022
39	N. T.	stacion plazhi	E. H.	L...V	Pogradec	28.07.2022	H.T. F.S.	28.07.2022
40	V. B.	stacion plazhi	K. S.	M...R	Pogradec	29.07.2022	H.T., F.S.	29.07.2022
41	J. 2..	stacion plazhi	S. H.	M...V	Vlorë	02.08.2022	H.T. F.S.	02.08.2022
42	N. C.	stacion plazhi	I. B.	L...J	Himarë	09.08.2022	H.T. F.S.	09.08.2022
43	P.	stacion plazhi	Th. R.	L...B	Himarë	09.08.2022	H. T. F.S.	09.08.2022
44	D. L.	stacion plazhi	V. C.	L...K	Sarandë	15.08.2022	M.B. F. V.	15.08.2022

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, me qëllim krijimin e një procesi transparent dhe të besueshëm për shqyrtimin e ankimit administrativ ndaj masave administrative të marra nga trupat inspektuese, të garantojë praninë e inspektorëve që kanë marrë vendimet administrative gjatë shqyrtimit të ankesave nga Komisioni i Ankimimit, pasi rezultojnë 8 raste të shfuqizimit të vendimeve administrative nga Komisioni i Ankimimit, për periudhën 2021-2022 ku nuk ka pasur prani të trupës inspektuese që ka marrë vendimin në autoritetin përkatës, si dhe janë kryer në total 12 komisione ankimi pa praninë e inspektorëve edhe përgjatë vitit 2024.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masat që në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të ngrejë grupe pune për përfundimin e Inventarit Kombëtar të Zonës Bregdetare, përmes plotësimit të hartave kadastrale sipas numrit të pasurive, identifikimit të strukturave akomoduese dhe të shërbimit; të rakordojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, mbi situatën e zonave bregdetare të hedhura në sistemin e regjistrimit fillestar, si dhe t’u kërkojë bashkive bregdetare statusin e regjistrimit të pasurive publike, përfshirë ato të transferuara, me qëllim krijimin e një inventari të zonës së bregdetit për të cilin duhet vijuar ndjekja për trajtimin në vijimësi të rekomandimit, referuar parregullsisive të evidentuara në raportin e mëparshëm të auditimit, përgjegjësi kjo e parashikuar nga pika 6, e VKM nr. 569, datë 17.07.2019, (aktualisht në fuqi), që përcakton se: “AKB-ja, në përputhje me kompetencat/ përgjegjësitë e veta, kryen këto detyra: a) Krijon dhe përditëson Inventarin Kombëtar të Zonës Bregdetare...”.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA DISIPLINORE:

B.1. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 59, pika 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i ri-kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit**, në vlerësim të parregullsive të konsideruara nga ana jonë, sipas pikës 1, shkronja “a” dhe “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës të atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të dërguar me shkresën nr. 561/19, datë 18.12.2023, në proporcion me shkeljet e konstatuara sipas nenit 58, shkronja “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”.

Menjëherë

Për të gjitha masat e dhëna të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar me statusin ***në proces zbatimi***, duke vlerësuar proceset e ndërmarra nga subjekti i audituar dhe afatet e nevojshme për implementimin e plotë të tyre, ri-kërkohet përmbushja e plotë e tyre **brenda vitit 2025**.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT